



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-009

Prishtinë, më 5 dhjetor 2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 DHJETOR 2017

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Aida Dërguti, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Albulena Haxhiu, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Sasha Milosavljeviq, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Valmir Klaiqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Ismet Mahmuti.

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha dhe

**Nga EUSR-ja:** Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

### **1. Formimi i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociim, ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, do të përbëhet nga trembëdhjetë (13) deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Ai propozoi që Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociim të jetë përbërja e Komisionit për Integrime Evropiane, por t'i shtohen edhe dy anëtarë: një (1) anëtar nga GP i LDK-së dhe një (1) anëtar nga GP i PDK-së, të cilëve u takon në bazë të formulës për ndarjen e komisioneve parlamentare, ndërsa për zëvendësanëtarë në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim grupet parlamentare duhet t'i propozojnë zëvendësanëtarët e tyre.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin lidhur me formimin e Komisionit Parlamentar për ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

Lidhur me formimin e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, Aida Dërguti, Kujtim Shala dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit, Albulena Haxhiu, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli, në emër të grupeve parlamentare. Diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Meqë nuk pati konsensus për formimin e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, Kryesia nxori këtë:

### **P ë r f u n d i m**

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që të përgatisë për Kryesinë e Kuvendit një opinion ligjor lidhur me formimin e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

**2. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb,**

**3. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e lartshënuara të rendit të ditës: Formimi i komisioneve ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb dhe për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa, nxori:

#### **P e r f u n d i m**

Kërkohej nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryesues, zëvendëskryesues dhe anëtarë për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb, si dhe për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.

Emërimi i kryesuesit, zëvendëskryesuesit dhe anëtarëve të komisioneve ad hoc do të bëhet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, përkatësisht sipas formulës për ndarjen e komisioneve funksionale dhe të përhershme.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*